



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 9, datë 20.11.2024

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMI PËR OBJEKTIN:

“5 MAJ” KOMPLEKS REZIDENCIAL DHE APART-HOTEL ME 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17 DHE 21 KATE MBI TOKË ME 3 KATE NËNTOKË, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË TIRANË

Në mbështetje të neneve 27, 28, 39 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, e ndryshuar, me propozim të shoqërive zhvilluese “Alb-Edil” sh.p.k, “Saimbei” sh.p.k dhe Person Fizik - Shkëlzen Kraja (Gend Invest), Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “5 Maj” Kompleks rezidencial dhe apart-hotel me 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17 dhe 21 kate mbi tokë me 3 kate nëntokë, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë, me subjekte zhvilluese shoqëritë “Alb-Edil” sh.p.k, “Saimbei” sh.p.k si dhe Person Fizik - Shkëlzen Kraja (Gend Invest).
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave si dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI

EDLA RAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
BELINDA BALLUKU

ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA

Nënshkruar më datë 26 03 / 2025